

GJYKATA E QARKUT NË PEJË

AP.nr.110/10

10 Nëntor 2010

NË EMËR TË POPULLIT

Kolegji prej tre gjyqtarësh, i Gjykatës së Qarkut në Pejë, i përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Malcolm Simmons, Kryetar i Kolegjit, Gjyqtari i EULEX-it Riku Jaakkola dhe Gjyqtari Vendor Salih Mekaj si anëtar të kolegjit,

Në lëndën penale kundër

GANI ÇEKU, i lindur me 31 Janar 1982, në Pejë, mashkull, nga babai Gazmendi, dhe nëna Safete, mbiemri i vajzërisë Rizaj, Shqiptar i Kosovës, me banim në Fushë të Pejës, beqar, i gjendjes së varfër ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, i pa dënuar më përpara,

I liruar se ka kryer veprën penale Lëndim i Rëndë Trupor, në kundërshtim me Nenin 154 paragrafi 1 pika 3 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Pejës P.nr.560/09 të datës 01.04.2010,

Duke vendosur mbi ankesën e palës së dëmtuar Ragip Muriqi të parashtruar me datë 30 Gusht 2010 dhe ankesës së Prokurorit Publik Komunal të parashtruar me datë 31 Gusht 2010,

në seancën e mbajtur me datë 10 Nëntor 2010, në prani të të liruarit Gani Ceku,

Pas këshillimit dhe votimit me datë 10 Nëntor 2010, lëshon këtë

AKTGJYKIM

Ankesat **refuzohen si të PABAZUARA.**

Aktgjykimi i Gjykatës Komunale të Pejës P.nr.560/09 i datës 01.04.2010 NDRYSHOHET *ex officio* dhe në këtë mënyrë i pandehuri lirohet se ka kryer veprën penale Lëndim i Rëndë Trupor, në kundërshtim me Nenin 154 paragrafi 1 pika 3 e KPK-

së, për shkak se nuk është dëshmuar se i akuzuari ka kryer veprimin për të cilin akuzohej.

Arsyetim

Me datë 27 Nëntor 2007, Prokurori Publik Komunal i Pejës parashtroj Aktakuzën PP. no.1487/2007 në Gjykatën Komunale të Pejës, kundër të pandehurit Gani Ceku, se ka kryer veprën penale *Lëndim i Rëndë Trupor*, në kundërshtim me Nenin 154 paragrafi 1 pika 3 e Kodit Penal të Kosovës (tani e tutje "KPK").

Me datë 13 Dhjetor 2007 Aktakuza në fjalë u konfirmua me Aktvendimin KA.nr.96/07 të Gjykatës Komunale të Pejës.

Shqyrtimi kryesor u mbajt në Gjykatën komunale të Pejës me datë 5 dhe 12 Mars 2008. Me datë 12 Mars 2008 u lëshua Aktgjykimi P.nr.10/08, duke shpallur fajtor të pandehurin për veprën penale *Lëndim i Rëndë Trupor*, në kundërshtim me Nenin 154 paragrafi 1 pika 3 e KPK-së dhe e dënoj atë me 120 ditë burgim.

Me datë 9 Korrik 2008, Gjykata e Qarkut në Pejë, duke vendosur mbi ankesat e të pandehurit dhe palës së dëmtuar, lëshoi Vendimin AP.nr.49/08, duke i refuzuar si te pabazuara që të dyja ankesat si të pabazuara dhe duke konfirmuar Aktgjykimin e shkallës së parë.

Me datë 5 Shtator 2008, i pandehuri parashtroi tek Gjykata Komunale e Pejës, një kërkesë për të rihapur procedurën gjyqësore, sepse janë zbuluar dëshmi të reja shfajësuese. Faktet e reja i referoheshin një dëshmitari të ri okular, Haki Lekaj si dhe ekspertizës së mjekësisë ligjore lidhur me lëndimet që pësoj i pandehuri.

Me datë 24 Shtator 2008, Kryetari i Trupit Gjykses i kërkoi të pandehurit që të siguroj dëshmi që mbështesin faktet e reja, siç parashihet me Nenin 444 (2) të KPPK-së, brenda 8 ditëve. Pasi që i pandehuri veproj vetëm me datë 13 Tetor 2008, gjykata me 14 Tetor 2008 hedh poshtë kërkesën për rihapjen e procedurës gjyqësore me Aktvendimin KP.nr.21/08, sipas Nenit 445 par. 1 pikës 5 së KPPK-së, për shkak të mospërputhjes me dispozitat e parapara me Nenin 444 të KPPK-së.

Me datë 13 Janar 2009, Gjykata e Qarkut në Pejë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër Aktvendimit KP.nr.21/08 të Gjykatës Komunale, përmes vendimit Pn. no. 142/08, miratoj ankesën, duke anuluar Aktvendimin e Gjykatës Komunale dhe duke dërguar lëndën në rishqyrtim.

Me datë 6 Shkurt 2009 Gjykata Komunale e Pejës pas rishqyrtimit të lëndës dhe duke pasur parasysh këshillat e Gjykatës së Qarkut të Pejës, lëshoi Aktvendimin KP.nr.1/06, me të cilin hodhi poshtë kërkesën për të rihapur procesin gjyqësor.

Me datë 26 Shkurt 2009 Gani Ceku parashtroi kërkesë të re për të rihapur procedurë.

Me datë 04 Maj 2009 kolegji prej tre gjyqtarësh i Gjykatës Komunale të Pejës hodhi poshtë këtë kërkesë.

Me datë 27 Korrik 2009 Gjykata e Qarkut në Pejë duke vepruar në bazë të ankesës së të Pandehurit lëshoi Aktvendimin Pn.nr.94/09, me të cili aprovoi ankesën, ndryshoi Aktvendimin e Gjykatës Komunale të Pejës dhe lejoi rihapjen e procedurës penale, duke pasur parasysh se faktet e reja ishin relevante dhe se duhej të merreshin parasysh.

Kështu që u rihap lëndë e re penale në Gjykatën Komunale të Pejës (P.nr.560/09).

Me datë 8 Dhjetor 2009, Kryetarja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, duke vendosur mbi kërkesën e palës së dëmtuar për të marrë këtë lëndë, e caktoj këtë lende për Gjyqtarët e EULEX-it.

Shqyrtimi kryesor u mbajt me datë 17, 18 dhe 31 Mars, dhe me datë 1 Prill 2010. Trupi gjykues përbëhej nga dy gjyqtar të EULEX-it dhe një Gjyqtar Vendor.

Me datë 1 Prill 2010 trupi gjykues lëshoi Aktgjykimin P.nr.560/09 me të cilin liroi Gani Çekun se ka kryer veprën penale *Lëndim i Rëndë Trupor* në kundërshtim me Nenin 154 paragrafi 1 pikën 3 të KPK-së.

Kundër këtij Aktgjykimi pala e dëmtuar Ragip Muriqi dhe Prokurori Publik Komunal parashtroan ankesa me datë 30, gjegjësisht 31 Gusht 2010.

Pala e dëmtuar e kundërshton aktgjykimin e shkalles së parë për shkak të shkeljes esenciale të Kodit të procedurës penale duke përfshirë, në mes tjerash, mungesën e Dispozitivit në Aktgjykim, arsyetimit të pakuptueshëm dhe mos shqyrtimit të Fjalës Përfundimtare të Palës së Dëmtuar, vlerësimit të gabuar dhe/apo jo të plotë të gjendjes faktike duke përfshi, në mes tjerash, dëshminë e Haki Lekaj dhe kundërshtimet/mospërputhjet me dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë mbrojtës, mos dhënies së besueshmërisë së duhur dëshmisë së Visar Muriqit dhe shkeljes së Kodit Penal.

Prokurori Publik kundërshton aktgjykimin e shkalles së parë mbi bazat e vlerësimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike duke përfshi, mes tjerash, të dhënat e diagnozës së lëndimeve që pësoi Pala e Dëmtuar dhe bazat ligjore mbi të cilat Gjykata e Shkalles së Parë e liroi të Pandehurin.

Në kohën e incidentit i Pandehuri ishte oficer i policisë në shërbim të Policisë së Kosovës.

Kurë ai dëshmoi para gjykatës me datë 18 Mars 2010, Haki Lekaj, duke iu referuar natës së 13/14 Gushtit 2007, tha se ishte rrugës për në shtëpi kurë pa dhe më pas foli me të Pandehurin, Sedat Gjogoviq dhe Xhevat Ibraj. Dëshmitari përshkroi se pa një Volkswagen Golf 2 të bardhë që po vinte nga qendra e qytetit dhe duke bërë një kthim -U në rrugë. Ai tha se i Pandehuri e ndaloi këtë veturë. Ai dëshmoi se dëgjoji të Pandehurin ti thotë vozitësit që të del nga vetura. I Pandehuri përsëriti kërkesën e tij. Vozitësi i veturës refuzoi ti bindej udhëzimit të të Pandehurit. Nuk ka diskutim se vozitësi i Golfit ishte Pala e Dëmtuar.

Dëshmitari tregoi se pa të Pandehurin që hapi derën e veturës dhe, prapë, i tha vozitësit të dilte jashtë. Ai tha se vozitësi i veturës ngriti dorën drejtë fytyrës së policit kështu që i Pandehuri e kapi vozitësin për krahun e majtë që rezultoi me një kacafytje të shkurtër. Një polic tjetër, Sedat Gjogoviq, intervenoi dhe ndihmoi të Pandehurin që të frenoj vozitësin për veturën e policisë. I Pandehuri dhe Oficeri Gjogoviq i prangosen vozitësin dhe e futen atë në veturën e policisë.

Dëshmia e Sedat Gjogoviqit nuk u dëgjua në gjykimin e parë në vitin 2008 sepse nuk ishte këtu, ishte jashtë shtetit. Trupi gjykues e shqyrtoi këtë dhe vendosi se dëgjimi i tij nuk ishte i domosdoshëm.

Kurë ai dëshmoi para gjykatës me datë 5 Mars 2008 Xhevat Ibraj deklaroi se natën e datës 13/14 Gusht 2007 ai ishte në detyrë së bashku me të Pandehurin dhe Sedat Gjogoviqin. Ai nuk pa momentin kurë i Pandehuri ndaloi Golf 2 e as nuk dëgjoi ndonjë gjë nga biseda që pasoi në mes të të pandehurit dhe Palës së Dëmtuar. Ai pa të pandehurin kurë shtyu Palën e Dëmtuar kundrejt Golf 2 dhe e kontrollloi atë. Ai tha se ndihmoi të pandehurin të prangoste Palën e Dëmtuar dhe ta vendoste atë në veturën e policisë.

Pala e dëmtuar dëshmoi me date 5 Mars 2008 se natë në fjalë ai po ngiste veturën e tij Volkswagen Golf 2, dhe se ishte në shoqëri me kushëririn e tij Visar Muriqi. Ai përshkroi se vetura e tij u ndalua nga i Pandehuri. Ai tha se i Pandehuri kërkoi nga ai që të paraqiste dokumentet e identifikimit. Nuk pati pretendime nga ana e Palës së Dëmtuar se sjellja e të Pandehurit atëbotë të kishte qenë tjetër veç se e njerëzishme dhe profesionale. Ai tha se ia dha dokumentet të Pandehurit përmes dritares së hapur të veturës. Ai tha se e pyeti të Pandehurin për arsyen e ndalimit të tij. Pala e Dëmtuar deklaroi se nuk e dinte pse ishte ndaluar nga policia. Ai tha se nuk ishte i dehur dhe se nuk po ngiste shpejtë.

Ai tha se u përpoq ti tregonte të Pandehurit drejtimin e vozitjes së tij dhe këtë e beri duke treguar me dorë. Ai dëshmoi se i Pandehuri e godit atë dy herë në dorë. A dëshmoi se i Pandehuri e urdhëroi atë të dilte nga vetura. Ai tha se refuzoi dhe i tha Oficerit që më parë të verifikonte dokumentet e tija. Ai tha se i Pandehuri e urdhëroi atë prapë që të dilte menjëherë nga vetura dhe në këtë moment pala e dëmtuar tha se ai hapi derën e veturës për të dalë jashtë dhe pastaj i Pandehuri e kapi për krahun e majtë dhe ia kthej prapa shpinës. Ai tha se i Pandehuri i ra shqelm në bark dhe e rrëzoi për tokë, pastaj tha ai u shqelmua dhe u qëllua me grushta. Ai deklaroi se pastaj ai e ngriti atë nga toka dhe e përplasi kundrejt veturës. Ai tha se oficeret e tjerë ndihmuan të Pandehurin dhe pastaj ai u prangos. Ai deklaroi se i Pandehuri përdori sprejin. Ai deklaroi se rrugës për në stacionin policor i Pandehuri dy herë i ra grusht në fytyrë.

Pala e dëmtuar u ekzaminua me datë 15 Gusht 2007 nga neuro-psikiatri. Në Raportin e tij specialisti diagnostifikon traum në kokën e Palës së Dëmtuar dhe thotë se kjo konsiston me të qenit i goditur me shkop në krahun e djathtë, qafë dhe shpinë. Në asnjë rast Pala e dëmtuar apo Visar Muriqi nuk kanë pohuar se Pala e Dëmtuar ishte goditur me shkop policie.

Visar Muriqi i cili po udhëtonte me veturë së bashku me Palën e Dëmtuar u ndalën nga i Pandehuri dëshmoi me datën 12 Mars 2008. Ai tha se i Pandehuri ndaloi veturën e tyre dhe i kërkoi Palës së Dëmtuar dokumentet. Ai tha se më pas i Pandehuri dy herë goditi Palën e Dëmtuar në dorë. Ai nuk asnjë sqarim pse bëri kështu i Pandehuri. Ai deklaroi se i Pandehuri urdhëroi Palën e Dëmtuar që të dilte nga vetura. Ai nuk zuri në gojë faktin se Pala e Dëmtuar, ne dëshminë e tij, kishte refuzuar të bënte një gjë të tillë përderisa i Pandehuri të kontrollonte dokumentet e tija. Ai deklaroi se Pala e Dëmtuar po dilte nga vetura kurë i Pandehuri e kapi Palën e Dëmtuar për krahë dhe filloi ta shqelmonte dhe grushtonte dhe e rrëzoi për tokë. Dëshmitari tregoi se i Pandehuri përdori sprej kundër Palës së Dëmtuar dhe se Pala e dëmtuar u mposht.

I Pandehuri deklaroi me datë 31 Mars 2010 se natën në fjalë ai ishte në detyrë me Sedat Gjogoviqin dhe Xhevat Ibraj, te udhëkryqi i Urrës së Zallit, në Pejë. Ai përshkroi se pa veturën VW Golf 2 të Palës së Dëmtuar që po ngitej me shpejtësi. Ai tha se ndaloi veturën dhe foli me vozitësin. Nuk diskutohet se Pala e Dëmtuar ishte vozitësi. Ai tha se Pala e Dëmtuar i dha dokumentet e tija ermes dritares së hapur. Ai tha se Pala e Dëmtuar pyeti se pse ishte ndaluar. I Pandehuri dëshmoi se po vinte erë e alkoolit dhe urdhëroi Palën e Dëmtuar që të dilte nga vetura. Pala e Dëmtuar refuzoj. I Pandehuri deklaroi se Pala e Dëmtuar kërkoi që më parë ti kontrolltoheshin dokumentet. I Pandehuri tha se ai ia përsëriti urdhrin Palës së Dëmtuar që të dilte jashtë veturës duke e paralajmëruar se mos zbatimi do të thotë mospërfillje e urdhrit të personit zyrtar dhe se mund të arrestohet. I Pandehuri dëshmoi se hapi derën e veturës dhe edhe njëherë urdhëroi Palën e Dëmtuar të dilte jashtë. Kurë dëshmoi me datë 12 Mars 2008 i Pandehuri tha se Pala e Dëmtuar kishte hapur derën. Ai deklaroi se kishte prekur Palën e Dëmtuar në krahë dhe prapë i kishte thënë atij të dilte nga vetura. Duket se lëvizja e papritur e Palës së Dëmtuar e befasoi të Pandehurin i cili e shtyu Palën e Dëmtuar dhe u zbraps. Ishte i Pandehuri ai që dëshmoi se Pala e Dëmtuar u rrezua për tokë. Ai e ngriti atë çka pasoi me një kacafytje gjatë së cilës iu gris këmisha e të Pandehuri dhe pësoi një lëndim në gishtin e katërt të dorës së majtë. I Pandehuri përdori sprejin për të nënshtruar Palën e Dëmtuar. Pastaj atij i ndihmuan oficeret e tjerë për të vene nen kontroll Palën e Dëmtuar.

Saud Koliq dhe Hajdar Ahmeti morën pjesë në hetimet që pasuan më vonë lidhur me supozimet për mos sjellje të mirë kundër të pandehurit. Asnjë oficer nuk ishte dëshmitar i ngjarjes së natës në fjalë.

Nuk ka dyshim se natën e datës 13/14 Gusht 2007 Pala e Dëmtuar ishte vozitësi i VW Golf 2 makinë udhëtaresh. Pasagjer i veturës në fjalë ishte Visar Muriqi. Vetura në fjalë u ndalua nga i Pandehuri tek Urra e Zallit në Pejë. Ka disa dyshime lidhur me arsyet e ndaljes. Janë disa dyshime lidhur me arsye e ndaljes. Nuk ka dyshim se i Pandehuri i kërkoi Palës së Dëmtuar të paraqiste dokumentet apo se Pala e Dëmtuar ia dha dokumentet të Pandehurit përmes dritares së hapur të veturës. Nuk ka dyshim se i Pandehuri i tha Palës së Dëmtuar që të dilte nga vetura apo se Pala e Dëmtuar refuzoi të veproi në pajtim me urdhrin e të Pandehurit. Më tej, shumë nga rrethanat faktike materiale janë të kontestueshme.

Pala e Dëmtuar tha se i Pandehuri e goditi atë dy herë në dorë. Kjo u mbështet nga dëshmia e Visar Muriqi.

Pala e Dëmtuar tha se ai (Pala e Dëmtuar) e hapi derën e veturës për të dalë jashtë dhe se atë çast i Pandehuri e kapi për krahun e majtë dhe ia ktheu prapa shpinës. Në deklaratën e tij Visar Muriqi tha se Pala e Dëmtuar po zbriste nga vetura kur u kap nga i Dëmtuari. Kur ai dëshmoi me datë 12 Mars 2008 i Pandehuri tha se ishte Pala e Dëmtuar ai i cili hapi derën e veturës.

Pala e Dëmtuar tha se i Pandehuri e shqelmoi atë në stomak dhe e rrëzoi për tokë para se ai të vihej nën kontroll kundrejt veturës. Visar Muriqi dëshmoi se Pala e Dëmtuar u grushtua dhe u shqelmua. I Pandehuri pranoi se e shtyu Palën e Dëmtuar i cili u rrëzua për tokë.

Nuk është diskutabile se spreji u përdorë. Pala e dëmtuar dhe Visar Muriqi than se përdorimi i sprejit ishte e tepërt. I Pandehuri tha se ishte e arsyeshme për shkak të sjelljes agresive të Palës së Dëmtuar kundrejt ti.

Pala e Dëmtuar dëshmoi se rrugës për në stacionin policor i Pandehuri dy herë i ra grusht në fytyrë. Nuk ka dyshim se i Pandehuri po ngjiste veturën.

Nuk ka dyshim se natën në fjalë ndodhi një zënkë e ashpër në mes të Pandehurit dhe Palës së Dëmtuar. Ishte dëshmia e

Palës së Dëmtuar se incidenti u nxit nga i Pandehuri i cili ishte agresori. Ishte rasti i të Pandehuri se ai po ushtronte funksionin e tij ligjor dhe së veproj me arsye.

Sipas shënimeve policore të asaj kohe, në ora 00.58 të datës 13 Gusht 2007 oficeret e policisë thirren oficerin policor në detyrë dhe mesazhi në vazhdim është shënuar

"po vijmë në stacion policor me një person të arrestuar për mos përfillje të urdhrin të policisë dhe sulm ndaj personit zyrtar".

I pandehuri më pas dorëzoi një raport për përdorim të forcës si formë-OC sprejin ndaj kundërvajtësit Muriqi. Në atë raport i Pandehuri deklaroi:

"derisa isha në detyrë me kolegët e mi, Rreshterin Xhevat Ibra dhe Sedat Dzagovic kundërvajtësi i cekur më lartë (Ragip Muriqi), pas mospërfilljes së urdhrin të personit zyrtar dyshohej në atë moment të ishte nën ndikim të alkoolit. Pas disa urdhrave të vazhdueshme të dhëna që të dilte nga vetura e tij, i njëjti nuk i përfilli ato. Në momentin kurë ai donte të dilte nga vetura ai u përpoq të më qëllonte por unë iu shmanga kësaj duke e shtyrë me dorë kurë kundërvajtësi u rrëzua. Në momentin kurë unë shkova me kolegët e mi që ta prangosim, ai më kapi për këmishe duke më këputur pullën e këmishës dhe prapë u përpoq të më qëllonte, por nuk ia doli. Derisa po mundohesha ta vija nën kontroll, i dyshimti ia doli të më kapte njërin gisht të dorës së majtë. Duke parë përgatitjen e tij fizike edhe pse në ishim tre kolegë nuk ishte e mundur ta vinim nën kontroll duke përdorur forcë të butë me duar të zbraza. Në atë moment i dyshimti më lëndoi gishtin, dhe për këtë kam raportin mjekësor, unë menjëherë e vlerësova dhe e pashë të arsyeshme për të përdorur sprejin duke u munduar që ta përdorja në sasi të vogël, vetëm që ta bëja të mundur që të venim të dyshimtin nën kontroll. Pas përdorimit të sprejit në menjëherë e vumë të dyshimtin në kontroll dhe e arrestuam atë."

I Pandehuri po ashtu është ekzaminuar me datë 13 Gusht 2007 në Emergjencën e Pejës dhe është treguar se kishte pësuar konfuzion në gishtin e katërt të dorës së majtë. Me datë 13 Gusht 2007 i Pandehuri mori një ditë të lirë mjekësore.

Me datë 14 Gusht 2007 Pala e Dëmtuar u dënua nga Gjykata për Kundërvajtje të Pejës për ngasje të veturës Golf nën ndikim të alkoolit me datë 13 Gusht 2007, rreth orës 02.10 minuta afër "Urës së Zallit" në Pejë.

Është konkluduar në fakt se Pala e Dëmtuar kishte koncentrik të alkoolit në gjak prej 1.38%. Kufiri ligjor për vozitje është 0.5%.

Me datë 14 Gusht 2007 është lëshuar një Aktvendim për lëndën 4-7875/07 nga Gjykata për Kundërvajtje ndërsa Pala e Dëmtuar Ragip Muriqi është gjetur përgjegjës penal për kryerjen e kundërvajtjes në kundërshtim me Nenin 226 (1) piken 25 të Ligjit mbi Sigurinë në Komunikacion, dhe ka marrë gjobën prej 85 Eurosh, si dhe masa parandaluese - ndalim i vozitjes për tre muaj i është shqiptuar palës së dëmtuar, si rrjedhim i incidentit të datës 13/14 Gusht 2007.

Me datë 14 Gusht 2007 është lëshuar Aktvendimi për lëndën 4-7876/07 në Gjykatën për Kundërvajtje me anë të së cilës Pala e Dëmtuar Ragip Muriqi po ashtu është shpallur përgjegjës për veprën penale të kryerjes së kundërvajtjes në kundërshtim me Nenin 18 (1) piken 11 të Ligjit mbi Rendin dhe Qetësinë Publike për mos zbatimin e urdhrave të policit për të dalë nga makina me datë 13/14 Gusht 2007. Ndaj tij është shqiptuar gjoba prej 80 Eurosh. Megjithatë, me datë 5 Shtator 2007 ky Aktvendim është pezulluar. Nuk është dhënë sqarim në Aktvendimin e datës së 5 Shtatorit 2007 për të sqaruar se pse Aktvendimi i datës 14 Gusht 2007 ishte pezulluar.

Nuk diskutohet se në ora 4.45 minuta të datës 13 Gusht 2007 Pala e dëmtuar është ekzaminuar në Pejë/Shërbimi Policor i Kosovës. Lista e vizitës mjekësore No9052, nuk shënon shenja të dukshme të lëndimeve të rënda; diagnoza ishte: "Contusio corporis" apo lëndim i trupit.

Nuk diskutohet se Pala e dëmtuar më tej është ekzaminuar në disa raste të tjera pasuese.

Me datë 27 Gusht 2007 është vërtetuar një thyerje e mollzës kryesore të kockës së krahut me një nxjerrje të vogël nga vendi.

Me datë 3 Shtator 2007 Pala e Dëmtuar është ekzaminuar nga dy doktor të Fakultetit të Mjekësisë, Institutit të Mjekësisë Ligjore të Prishtinës të cilët diagnostifikuan thyerje të

tuberculum maius (mollëzës së madhe) të humerus-it (kockës së krahut) të majtë, ndrydhje të indeve të buta të nyjeve/kyçeve të shpatullës së majtë, të pjesës së shpatullës së djathtë dhe pjesës së prapme si dhe ndrydhje të indeve të buta të pjesës së legenit të anës së djathtë, e shkaktuar nga një veprim mekanik të një mjeti të fortë dhe të rëndë, në tërësi janë pjesë e lëndimit të rëndë trupor.

Pati mospajtime në mes palëve lidhur me zanafillën e saktë të lëndimeve të pësuar nga Pala e Dëmtuar. Natën në fjalë ai qartazi ankohej për një lëndim.

Kuptimi i dhënë natyral dhe i zakonshëm për "lëndim trupor" siç parashihet me Nenin 154 të KPK-së nuk kërkon sqarim "I rëndë" do të thotë as më pak e as më shumë se sa "vërtetë serioz".

Nëse lëndimi për të cilin Pala e Dëmtuar ankohet dhe e dokumenton me raporte të ndryshme mjekësore është shkaktuar nga i Pandehuri ne pajtohemi se ishte vërtetë serioz.

Nuk është e qartë se si është shkaktuar lëndimi në shpatullën e Palës së Dëmtuar. Është e mundur të jetë rezultat i rrëzimit të tij në tokë. Është njëlloj e mundur të jetë rezultat nga vënia nën kontroll të tij. Dëshmia në këtë rast është e dykuptimshme.

Ndjekja penale duhet të dëshmoi se i Pandehuri veprroi në mënyrë joligjore dhe se ai ose kishte qëllim apo në të vërtetë parashikoi se veprimet e tija natën në fjalë mund të shkaktonin ca lëndime.

Nuk është e domosdoshme që të dëshmohet se a kishte i Pandehuri qëllim ose parashikoi se veprimi jo ligjor mund të shkaktoj lëndim fizikë të peshës siç përshkruhet me Nenin 154. Është e mjaftueshme se i Pandehuri parashikoi se mund të rezultonin lëndime fizike, edhe pse me karakter të vogël.

Në këtë rast i Pandehuri po vepronte në pajtim me ligjin Ai pa Palën e Dëmtuar duke vozitur në mënyrë të çoroditur. Ai ndaloi Palën e Dëmtuar dhe i kërkoi atij dokumente. I pandehuri kundërmonte alkool. Ai urdhëroi Palën e Dëmtuar që të dilte nga vetura. Pala e dëmtuar refuzoi. Ka dyshime për atë se çfarë ndodhi saktësisht më tej. Sipas vlerësimit të Palës së Dëmtuar për atë se çka pasoi më tej i Pandehuri ishte agresor. Versioni i tij për ngjarjen u mbështet tej mase nga kushëriri i tij i cili ishte bashkudhëtar në këtë

veture. Ishte rrethanë për të Pandehurin që Pala e Dëmtuar nuk përfilli urdhrin e tij dhe pastaj u soll në mënyrë agresive ndaj tij. Për fat të keq nuk ka dëshmi të sakta të pavarura lidhur me këto ngjarje. Që të dy edhe Pala e Dëmtuar edhe i Pandehuri pësuan lëndim. U përdor edhe spreji. Shënimet policore të asaj kohe shënojnë momentin kurë oficerit njoftuan oficerin në detyrë lidhur me incidentin dhe natyrën e tij. I pandehuri bëri një raport lidhur me përdorimin e forcës që ai bëri dhe përdorimin e sprejit.

Oficeri policor mund të përdorë një forcë të tillë sepse është e arsyeshme në rrethanat që oficeri i policisë besoi të ekzistonin në atë.


Duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e këtij rasti, duke përfshirë këtu natyrën dhe shkallën e forcës së përdorur si dhe sjelljen e Palës së Dëmtuar, erdhëm në përfundim se përdorimi i forcës dhe shkalla e saj ishin të arsyeshme.

Me këtë rast nuk u dëshmua se i Pandehuri kreu veprimin për të cilin akuzohet.

Për arsyet e cekura këtu u vendos si në Dispozitiv.

Daton, me 10 Nëntor 2010.

Gjyqtari Malcolm Simmons
Kryetar i Kolegjit



Gjyqtari Salih Mekaj
Anëtar i Kolegjit

Gjyqtari Riku Jaakkola
Anëtar i Kolegjit